



Agjencia e Akreditimit e Kosovës  
Kosovo Accreditation Agency  
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 38 213-722  
Fax:: +381 38 213-990  
e-mail: [kaaoffice@gmail.com](mailto:kaaoffice@gmail.com)  
web: [www.akreditimi-ks.org](http://www.akreditimi-ks.org)

Nr. 310/11 13.07.2011

## **Për: UP - Fakulteti i filologjisë**

### **Njoftim mbi vendimin**

Mbështetur në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë (Rr. nr. 2003/14), Udhëzimin Administrativ mbi Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (nr. 14/2004) dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 2/ 2009), dëshiroj t'ju njoftoj se ne Mbledhjen e XIX-te, me 06.07.2011, Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për akreditim/ riakreditim të programeve të studimit (R-02/02/11) dhe ka vendosur si në vijim:

#### **A. Programet e studimit:**

- Gjuhë dhe letërsi gjermane/ BA
- Gazetari/ BA
- Gazetari dhe kontakte me publikun/ MA

Riakreditohen për periudhë 3 vjeçare (1 tetor 2011-30 shtator 2014)

#### **B. Programi i studimit:**

- Ballkanistikë/ BA

Akreditohet për periudhë 1 vjeçare (1 tetor 2011-30 shtator 2012)


#### **C. Programi i studimit:**

- Përkthim dhe interpretim/ MA

Akreditohet për periudhë 1 vjeçare (1 tetor 2011-30 shtator 2012) me kusht që se paku 1 muaj para fillimit të programit:

1. Pajisjet të jenë të instaluara dhe të gatshme për përdorim: kabinat e interpretimit, harduerët/kompjuterët, softuerët (veçat për asistencë në përkthim të bazuara në kompjuter, siç janë sistemet e memories për përkthim, bazat e të dhënave të terminologjisë). Këto pajisje do të ndikojnë edhe në sesionet e trajnimit për mësimdhënës (si të përdoren këto pajisje, si të integrohen në trajnim),
2. Kompetencat dhe rezultatet e mësimi të riformulohen pjesërisht në mënyrë që të evitohen përsëritjet,
3. Lëndët të përshkruhen në mënyrë më specifike, të ceken kompetencat të cilat synohen të arrihen.
4. Të ofrohen më shumë detaje në lidhje me atë se si studentët do të marrin njohuritë e specializimit në fusha të caktuara (drejtësi, mjekësi, ekonomi) në planin e studimeve duhet të sqarohen vendi dhe shtrirja e specializimit.
5. Të përcaktohen lëndët që do të ofrohen si gjuhë e huaj zgjedhore (C, D)
6. Të ofrohet një lëndë në lidhje me metodologjinë hulumtuese që duhet t'i ofrohet studentëve, në mënyrë që ata të përgatiten për punë kërkimore në lidhje me tezën e masterit dhe
7. Të ofrohen informata të qarta dhe precize në lidhje me atë se si do të orientohen studentët për vitin e dytë (drejtimi "përkthim" ose drejtimi "interpretim")

D. Institucioni i juaj është i obliguar që të harton një Plan të përmirësimit (ne gjuhen shqipe dhe gjuhen angleze, ne versionin e shtypur dhe ne atë elektronik) në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i ekspertëve dhe ta dorëzoni në AAK, përmes ZZHA, gjer më 1 nëntor 2011.

  
Ferdije Zhushi Etemi, kryetare  
Këshilli Kombëtar i Cilësisë  
Agjencia e Akreditimit e Kosovës

